VENDIM
Nr.33, datë 26.5.2006

PËR MIRATIMIN E TARIFËS MESATARE TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT QË KRYEN OST SHA PËR VITIN 2006

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, dhe 41, të ligjit 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 "Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.05.2006, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria OST sh.a. për miratimin e tarifës mesatare të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, që kryen OST sh.a. për vitin 2006,

VENDOSI:

1. Tarifa mesatare e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike që kryen OST sh.a. për vitin 2006, të jetë 0,45 lekë/KWh.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema